

CRNA GORA
MALI I ZI
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT
Sekretarijat za upravu i
društvene djelatnosti
Sekretarijati për administratë
dhe veprimtari shoqërore
Br./nr: 03-609/21-_____
Ulcinj/Ulqin, 06.10.2021. godine

Në bazë të nenit 6, paragrafi 1 të Vendimit për bursat dhe shpërblimin e studentëve („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 36/19), Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore, shpallë

KONKURS PUBLIK
për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve studentëve për vitin shkollor 2021/2022

Komuna e Ulqinit do të bëjë alokimin e bursave dhe shpërblimeve studentëve pas përfundimit të vitit të parë të studimeve (vëllimi i programit studimor për një vit, dmth 60 ECTS) në institucionet e arsimit të lartë, pa marrë parasysh vendin e studimeve, të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me Vendimin për bursa dhe shpërblimin e studentëve („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 36/19).

1. Të drejtën e bursës e kanë kandidatët – studentët të cilët:

- a) Sipas programit mësimor të institucionit të arsimit të lartë në të cilin studiojnë kanë arritur indeksin e suksesit së paku 9,0, pa marrë parasysh vendin ku studiojnë.
- b) Shtetasit e Malit të Zi që vendbanimin e kanë në Komunën e Ulqinit.
- c) Rregullisht e kanë regjistruar vitin e studimeve.
- d) Nuk e kanë humbur asnjë vit gjatë studimeve dhe
- e) Nuk janë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

2. Të drejtë në bursë kanë edhe studentët me aftësi të kufizuara, anëtarët e komunitetit rom, përfituesit e sigurisë materiale (në vazhdim përfituesit SM), pa marrë parasysh notën mesatare nga viti paraprak, me kusht që të jenë:

- a) Shtetas të Malit të Zi me vendbanim në territorin e Komunës së Ulqinit,
- b) Rregullisht e kanë regjistruar vitin e studimeve,
- c) Nuk e kanë humbur asnjë vit gjatë studimeve dhe
- d) Nuk janë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

3. Me aplikimin me dëshmitë për plotësimin e kushteve nga konkursi i shpallur kandidatët janë të detyruar të bashkangjesin edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) çertifikatën e nënshtetësisë,
- b) vërtetimin e vendbanimit,
- c) vërtetimin për regjistrimin e rregullt të vitit të studimit,
- d) vërtetimin për provimet e dhëna nga viti paraprak,
- e) vërtetimin për notën mesatare të arritur,

- f) çertifikatën nga regjistri i të lindurve dhe
- g) vërtetimin që nuk është i punësuar në kohë të pacaktuar.

Personat me aftësi të kufizuar me aplikimin për konkurs përveç dokumenteve nga pika 3, Alinea a, b, c, d, f, g dorëzojnë edhe aaktvendimin me të cilin është konfirmuar statusi SM në pajtim me dispozitat e posaçme.

Anëtarët e komunitetit rom me aplikimin për konkurs bashkangjesin dokumentet nga pika 3, alinea a, b, c, d, f, g edhe deklaratën që janë anëtarë të komunitetit rom.

Përfituesit e SM me aplikimin për konkurs, përveç dokumenteve nga pika 3, alinea a, b, c, d, f, g bashkangjesin edhe aktvendimin për realizimin e të drejtës në SM.

Studentët që konkurrojnë për alokimin e bursës janë të detyruar që dokumentacionin që kanë në gjuhën e huaj ta përkthejnë në gjuhën zyrtare.

Është e nevojshme që dokumentacioni të dorëzohet në origjinal ose në fotokopjen e vërtetuar. Komisioni nuk bënë kthimin e dokumentacionit të dorëzuar.

Afati për parashtrimin e aplikimit është prej, më 07. 10. 2021 deri, më 08. 11. 2021.

Aplikimet paraqiten në adresën: Komuna e Ulqinit – Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore, me shënimin për Komisionin për ndarjen e bursave ose në sportelin e Byrosë së qytetarëve të Komunës së Ulqinit.

Formulari i aplikimit mund të merret në sajtin e Komunës www.ul-gov.me ose në sportelin e Byrosë së qytetarëve.

Ky organ nuk do t'i marrë në shqyrtim aplikimet e mbërritura pas përfundimit të afatit të konkursit.

Informata shtesë mund të fitohen në cel: 069241-734, personi për kontakt: Mirjeta Gjoni.

U.D.SEKRETARI,
Brahim Leši